



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr. 12-060-41743 dt. 01/10 2020

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. 16.09.2020, ora 10:00.
Mbledhjen e kryesoi Labinot Halilaj-Kryesues.

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për politikë dhe financa ku të pranishëm ishin anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Kryesuesi i Komunës Labinot Halilaj, Gani Podrimqaku, Florentina Elezi, Fitore Morina, Edolina Plakiqi, mungon Burim Bujupi me arsye. Prezent gjatë mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa ishin: Nënkryetari i Komunës Nazmi Hasi, shefi i Kabinetit të Kryetarit Flamur Curri, Drejtori për Buxhet dhe financa Shyqyri Bublaku, Drejtori për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë: Ruzhdi Lestrani.

Komiteti filloi punimet më këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 24.08.2020.
2. Propozim Vendim për këmbimin e njësive të ndërtesave (banesave) në zonën Kadastrale në Gllgoc.
3. Propozim Vendim për shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik të pronave të paluajtshme (njësive të ndërtesave-Banesat), në parcelën nr. 743-1, në zonën Kadastrale në Drenas.
4. Propozim Vendim për shfuqizimin e vendimit për definimin dhe parcializimin e të gjitha varrezave të cilat ndodhën në prona komunale në Komunën e Drenasit.
5. Propozim Vendim për caktimin e lokacionit, për vendosjen e Bustit të Heroit të Kombit Fetah Kiqina.
6. Propozim Vendim i Buxhetit të Komunës për vitin 2021 dhe parashikimi i Buxhetit për vitet 2022-2023.
7. Raporti i zyrës Kombëtare të Auditimit.
8. Plani i implementimit të rekomandimeve të zyrës Kombëtare të Auditimit
9. Raporti i proformancës Komunale për vitin 2019
10. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj: hapi mbledhjen e KPF, pasi përshëndeti të pranishmit, prezantoi rendin e ditës, i njoftoi anëtarët e KPF-ca se kemi një ndryshim të pika e gjashtë që do të prezantohet dhe të pika nëntë kemi edhe një pikë shtesë për rendin e ditës:

1. Raporti i proformancës Komunale për vitin 2019, te ndryshimet drejtorit ja kisha dha fjalën në lidhje me ndryshimet me na njoftua.

Shyqyri Bublaku ju kisha njoftua se Qarkorja Buxhetore 2021/03, ka ardhur dje në ora 11.58, dhe kemi punua për me mujt me hartua propozim vendimin e buxhetit i cili ka pësua ndryshime ndryshimet janë se grandit qeveritar për komunën e Drenasit janë zvogëluar për 243.609 €, ndërsa te hyrat vëtanake janë zvogëluar 84.130€, krejt ndryshimi në buxhet për vitin 2021, është 327.739, i cili ka interperu edhe në buxhetin e vitit 2021, ku i keni edhe tabelat e paraqitura, mirë po është një plus që në kategorinë e investimeve kapitale kemi një ngritje prej propozim vendimit të parë tash është 4.108000€, buxheti për investime kapitale për vitin 2021, ka qenë 3.383000€.

Pasi nuk pati diskutime **tjera Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj**- hodhi në votim rëndin e ditës së bashku me një pikë shtesë, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtarë:

Për votuan 6 anëtar

Kundër nuk pati.

Abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KPF-ca të dt. 24.08.2020.**

Pasi nuk pati diskutime **Kryesuesi i Kuvendit** - hodhi në votim pikën e parë të rendit të ditës prezent gjatë votimit ishin 6 anëtarë:

Për votuan 6 anëtar

Kundër nuk pati.

Abstenim nuk pati.

Kaloim te pika e dytë e rendit të ditës: 2 . Propozim Vendim për këmbimin e njësive të ndërtesave (banesave) në zonën Kadastrale në Gllogoc.

Fjalën e merr **Drejtori për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë: Ruzhdi Lestrani për sqarim të vendimit.** Para juve është një propozim vendim për këmbimin e njësive të ndërtesave në zonën kadastrale në Gllogoc, kërkoj që të miratohet propozimi i kryetarit të Komunës për këmbimin e pronave të paluajtshme Komunale banesave me pronat të paluajtshme të pronarëve privat që janë dhënë në shfrytëzim të përhershëm nga Komuna në zonën kadastrale në 743/1 në Gllogoc.

Kuvendi i Komunës së Drenasit/Gllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.04.2020 ka miratuar vendimin nr. 12-020/04 për formimin e komisionit për vlerësimin e pronave që mund të këmbehen dhe dhënien e rekomandimeve për pronat që duhet të shpronësohen, në parcelën 743-1, në zonën kadastrale në Gllogoc.

Komisioni i formuar me qëllim vlerësimin e pronave (banesave) pas përfundimit të punës ka dhënë rekomandim se objektet banesore të cilat janë në shfrytëzim të përhershëm të ndërtuara në pronën komunale të shënuara më lartë, mund të këmbehen me banesat të cilat komuna i posedon. Qëllimi për këmbimin e këtyre objekteve banesore është bërë për realizimin e interesit publik të Komunës së Drenasit konkretisht për projektin e Planit Urbanistik, hapsinor dhe Zhvillimor Komunal. Të bashkangjitur keni certifikatat e njësive kadastrale, dhe skicat e njësive banesore.

Kryesuesi i Kuvendit ka dikush rreth pikës së dytë po fjalën e merr Florentina Elezi do me tha te këmbehen ndërtesat që janë në pronën e komunës apo çfarë këmbimi, keni me ja marr ato

ku janë duke jetuar tani për me ja dhen më këmbim,ku a keni biseduar me banoret e këtyre ndërtesa te kësaj zone dhe a janë pajtua se me disa banor qe unë jam taku ata nuk kanë njohuri për këtë çështje.

Drejtori për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë: Ruzhdi Lestrani- si pas ligjeve dhe rregulloreve ne fuqi ne i këna marr te gjitha masat paraprake konkretisht ne vitin e kaluar na kemi bisedua me të gjithë pronarët i kemi shënimet për te gjithë jam kontaktua me gjithë a janë pajtua na hala se dimë i kemi njoftua për procedurat, e drejta ligjore e tyre është kur te kanë dëshirë mos mu pajtua rreth vlerësimit kompensimit është e drejt e çdo qytetari me bo ankese ato tani vlerësohet ne gjykate.

Florentina Elezi- kjo mënyra e këmbimit si shkon metër për metër a si e vlerësoni se do i kishin 30 m², dhe me ato metra, ku kanë me shku se tash familjet janë rrit a e keni parapa këtë a si kanë mu vlerësua sipas ligjit.

Drejtori për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë: Ruzhdi Lestrani- vlershmin e pronave edhe pronave komunale edhe pronat që posedon Komuna edhe njërive banesore të Komunave të cilat do të merren në këmbim edhe ato të cilat do të shpronësohen i vlerëson Ministria e Financave departamenti i tatimit në pronë, zyra për vlershmin e pronave të paluajtshme. Pastaj ne mundem me bë ankese për vlerësimin e objekteve tona por edhe qytetarët mundën me bë ankese për objektet e tyre.

Pasi nuk pati diskutime **Kryesuesi i Kuvendit** - hodhi në votim pikën e dytë të rendit e ditës prezent gjatë votimit ishin 6 anëtarë:

Për votuan 4 anëtar

Kundër 1 anëtar

Abstenim 1 anëtar

Kaloim te pika e tretë e rendit të ditës: 3. Propozim Vendim për shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik të pronave të paluajtshme (njësive të ndërtesave-Banesat), në parcelën nr. 743-1, në zonën Kadastrale në Drenas.

Fjalën e merr **Drejtori për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë: Ruzhdi Lestrani** për sqarim të vendimit: Në mungesë të njësive banesore të Komunës se këto banesa janë me metrazh të vogël ku fillon nga 30 deri në 35m², ma e madhe ne jemi të obliguam me kalu me shpronësim, vlerësimin e objektit do ta bënë Ministria e Financave,departamenti i vlerësimit në pronë ,zyra për vlerësim të këtyre pronave edhe pas vlerësimit të tyre e drejta e qytetarit është të atakoi vlerësimin e zyrës ligjore . Banesat që do të shpronësohen janë shtatë dihen që këto janë objekte banesore janë një katërshe, përdhese ka banesë që janë tre pronar,banesat që folëm më herët janë nga 58m deri në 63metra. Këto janë mungesë që na s'kemi për afërsisht banesa të llojit të tyre,s'kemi kujt me kalu me këmbim edhe pse nuk posedojmë banesa të tilla. Metrazhi është e vogël dhe tash ligji i ri nuk e lejon, ma herët ka qenë e ka paguar pjesën shtesë ,ashtu si ju ka nevojite në bazë të familjes .Tash nuk e lejon ligji edhe pse ligji është i dis-favorshëm edhe për komunën edhe për qytetaret pritet që ky ligj të ndryshohet dhe të plotësohet komplet ,sepse është i papërshtatshëm për të gjithë arteret.

Kryesuesi i Kuvendit ka dikush rreth pikës së tretë po fjalën e merr Florentina Elezi-interesi i përgjithshëm sipas jush është me ndërtua banesa të larat ,kush me banu në ato ndërtesa

të larta se unë e di se kur shpallet një pronë në të interes të përgjithshëm duhet me u hap diçka në interes të komunitetit çka përfiton shoqëria, si hin në interes të qytetarit ,kështu që unë nuk po shoh një far interesi në favor të komunitetit me ju shit personave individual banesat ,a mund të me sqaroni për interesin e përgjithshëm konkretisht?

Fjalën e merr **Drejtori për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë: Ruzhdi Lestrani**-janë disa kushte për me u shpall interes i përgjithshëm kur dihet që është Drenasi I zona urbanistike kryesorja e qytetit planifikimet kanë fillua në vitin 2010, janë bërë planifikimet zhvillimore urbanistike tash dihet që si Komunë jemi duke përgatitur hartën zonale, tash janë të planifikune ato por masa paraprake që janë duke u merr janë se duhet mu shpall interes i përgjithshëm duhet mu krye procedurat paraprake tani duhet të bëhet një hartë zonale me PZHK tani shihet se çka kanë vendos në interes,kjo është e bazune në PZHK.

Florentina Elezi- ti po thu që niher këna me shpall interes të përgjithshëm pastaj këna me këqyr se çka këna me bë, a ma qysh me votua unë këta për ose kolegët e mij kur na nuk e dina qka ka mu ba. Më fal a ma nëse më kishe pru ti mu diçka që ka mu hap qitu ni çerdhe që këna mungesë ekstreme ose që këna me hap një shkollë unë e kisha jep menjëherë votën . Ju na keni sjellë ni letër që keni me ndërtua ndërtesa të larta të paktën s'keni thanë që keni me ndertu lokale dy tri katërshe mi ndihmua me një çmim të volitshëm bizneset e Komunës së Drenasit me zhvillu qytetin. Ju për mua keni përmend ndërtesa të larta për mua nuk është aspak bindëse që më vjen keq qe kolegët e mi duhet me votua për shkak se i përkasin partisë suaj. Ku unë s'po shoh kuruar interesi, e arsyeja jote është zero. Unë si qytetare e Drenasit që paguaj taksë çka kam me fitua prej ndërtesave të larta.

Nënkryetari i Komunës Nazmi Hasi- vetëm për sqarim zonja Elezi nuk është çështja se e ke kuptua jo drejtë nuk është çështja me ndërtua ato banesa po në atë zonë në të cilën po kërkohet të shpallet interes i përgjithshëm ndodhen banesat a po kupton destinomi i tyre do të përcaktohet me akte tjera ndërtime të reja kaq si sqarim.

Florentina Elezi- atëherë ose keni bë gabime drejtshkrimore zoti nënkryetar se për me dal prej situatë shpesh herë mundni me tha është gabim teknik e kuptoi,po ti the që unë e kam kuptu gabim, ku ky plan pareshe diçka që mu bë se jo diçka se qi është,se në këtë pjesë të bëhen ndërtime të larta mos u mundoni zotrij mëmë hurdhë hi syve se nuk po e shoh të arsyeshme aspak me e votua vota ime është kundër.

Pasi nuk pati diskutime **Kryesuesi i Kuvendit** - hodhi në votim pikën e **tretë** të rëndit e ditës prezent gjatë votimit ishin 6 anëtarë:

Për votuan 4 anëtar

Kundër 1 anëtar

Abstenim 1 anëtar

Kaloim te pika e katër e rendit të ditës: 4. Propozim Vendim për shfuqizimin e vendimit për definimin dhe parcializimin e të gjitha varrezave të cilat ndodhën në prona komunale në Komunën e Drenasit.

Fjalën e merr **Drejtori për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë: Ruzhdi Lestrani për sqarim të vendimit**: Shfuqizimi i këtij vendimi ka arëdhë si kërkesë e MPL,me vendimin për Ligjshmëri Nr.06-020-545/13. Kuvendi i Komunës së Drenasit sipas Vendimit Nr. 12 Nr.352/05-28772 të datës 30.07.2020 e ka nxjerrë vendim që të bëhet definimi dhe parcelizimi i të gjitha parcelave

kadastrale pronë komunale e Komunës së Drenasit, në të cilat ndodhen varrezat, qëllimi i nxjerrjes së këtij vendimi ka qenë që të bëhet rrethimi, mirmbajta e këtyre varrezave nga drejtoria për shërbime publike.

Por MPL me vendimin *për ligjshmëri Nr.VI-020-545/13 të datës 19.08.2019, ka vlerësuar se akti i komunës së Glllogocit duhet të jetë i harmonizuar me dispozitat e legjislacionit në fuqi, konkretisht me Ligjin nr.04/L-174, Për Planifikim Hapësinor, si dhe Udhëzimit Administrativ 24/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës*. Deri në një vendim tjetër të harmonizuar, Kuvendi i Komunës së Drenasit shfuqizon vendimin e lartë cekur deri në hyrje të vendimit të hartës zonale të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj; Ka dikush diçka jo hedhim në votim:
Për votuan 6 anëtar, Kundër 0 anëtar ,Abstenim 0 anëtar.

Kaloim te pika e pestë e rendit të ditës 5. Propozim Vendim për caktimin e lokacionit,për vendosjen e Bustit të Heroit të Kombit Fetah Kiqina.

Fjalën e merr ***Drejtori për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë: Ruzhdi Lestrani për sqarim të vendimit:*** Duke pas parasysh kontributin e dhënë të Dëshmorëve të Kombit për çlirimin e vendit, Komuna e Drenasit me kërkesë nga familja e Heroit “Fetah Kiqina”, e ka parë të arsyeshme që të bëjë caktimin e lokacionit për vendosjen e Bustit, në afërsi të rrugës e cila e ka emrin e Heroit ‘Fetah Kiqina’.

Familja e Heroit ka parashtruar kërkesë me datë 28.08.2020 me nr, të referencës 01-070/35560, ku ka kërkuar nga Kryetari dhe Komuna që të bëjë caktimin e një lokacioni për vendosjen e Bustit, afër rrugës e cila e ka emrin e Heroit ‘Fetah Kiqina’.

Po ashtu familja në kërkesë ka cekur se sa i përket vendosjes dhe rregullimit të Bustit do të angazhohet vet.

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ka kryer të gjitha matjet e nevojshme gjeodezike dhe ka përgatitur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për definimin dhe caktimin e lokacionit të shënuar më lartë. Të bashkangjitur keni kopjen e planit dhe certifikatën e pronësisë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj; flitet për një lokacion në fshatin Baicë aty ku e ka edhe rruga emrin, vetëfinancimin e bëjnë familja na kemi obligim moral dhe Kombëtar ti ja caktonim lokacionin. Ka dikush diçka jo hedhim në votim pikën e pestë:

Për votuan 6 anëtar, Kundër 0 anëtar ,Abstenim 0 anëtar.

Kaloim te pika e gjashtë e rendit të ditës 6. Propozim Vendim i Buxhetit të Komunës për vitin 2021 dhe parashikimi i Buxhetit për vitet 2022-2023.

Fjalën e merr ***Drejtori për Buxhet dhe Financa Shyqyri Bublaku,*** për sqarimin e ndryshimit të Qarkores-po ju njoftoi se Korniza afatmesme i paraprin çdo hartimit të buxhetit ,korniza e dytë për vitin 2021,është hartua me datën 14.09.2020,në Qeverinë e Kosovës e cila i përcakton Kufijtë buxhetor për të gjitha Komunat e Kosovës dhe për Ministri, do me thanë për nivelin Qendror dhe për nivelin Lokal. Këtë qarkore e kemi marrë me datën 15.09.2020,në ora 10.58 m ku në të njëjtën shkresë janë përcaktua kufijtë për të gjitha kategoritë e shpenzimeve dhe ne duke u bazuar në qarkoren e tretë i kemi hartua kufijtë buxhetor për të gjitha kategoritë duke u bazua në qarkore. Këtu në propozim Vendimin e Buxhetit Komunal e kemi tabelën për të gjitha

drejtoritë dhe zyrat komunale sa do të kenë buxhet ,ju njoftova dhe ma herët se kemi pas shkurtim të buxhetit nga grandit qeveritar në shumën prej **243,609,00 €**,ndersa nga të hyrat vetanake na kanë zvogëluar burimin e të hyrave vetanake **për 84.130.00€**. Është pjesa e dytë e zvogëlimit të hyrave vetanake është një e mirë për Komunën se është problem në këtë vitë kalendarik na me mbërri mi realizua si duket kjo tendencë do të zgjas edhe vitin tjetër ,diku afër 60 kemi ralizua të hyra vetanake në këtë vit po nuk besoi që do të mbërrim ta realizojmë % përqindjen e planifikimit të hyrave vetanake do me tha të hyrat vetanake janë pjesë e buxhetit për çdo vit andaj nuk ju kisha marrë kohë kush ka me pyet dikush diçka .Buxheti për investimet kapitale është rritë pak po kemi ndiku te kategoritë tjera edhe shuma për vitin 2021 është me vlerë prej, **15.399,334**,do me thanë burimet e financimit sektori i përgjithshëm për vitin **2021**,është **6.842.147**, në sektorin e arsimit **6.472.573**, sektorin e shëndetësisë **2.084.614**. këto shuma janë me të hyra vetanake është tabela e parë ku i para në propozim Vendim prej kah i paraqet burimet e fondeve prej kahë janë marrë mjetet në buxhet në për drejtoritë dhe zyrat komunale. Diçka tjetër nuk ka, a ka dikush me pyetë diçka.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- unë po them te inkasimi i te hyrave vetanake ka ndikuar nga Vendimi për lirim të taksave të bizneseve . Ka dikush diçka hedhim në votim pikën e gjashtë: **Për votuan 6 , Kundër 0 ,Abstenim 0 .**

Kaloim te pika e shtatë e rendit të ditës 7. Raporti i zyrës Kombëtare të Auditimit.
Ka dikush diçka rreth raportit të Auditimit jo, rekomandoim për Kuvend.

Kaloim te pika e tetë; 8. Plani i implementimit të rekomandimeve të zyrës Kombëtare të Auditimit, ka dikush diçka jo rekomandoim për Kuvend.

Kaloim te pika e nëntë 9. Raporti i proformancës Komunale për vitin 2019, ka dikush diçka pra rekomandoim dhe këtë pikë për Kuvend.

Hapi diskutimin për pikën e dhjetë të rendit të ditës: 10. Të ndryshme.

Pasi nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime, kryesuesi i Kuvendit Komunal konsideroi të mbyllur seancën.

Mbledhja përfundoj rreth orës: 10: 42 min.

Drenas 24.09.2020

Procesmbajtëse:

Zahrie Podrimqaku Subashi

